

Formular për SYLLABUS të Lëndës Metodologjia e shkrimit ligjor

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik		
Titulli i lëndës:	Metodologjia e shkrimit ligjor		
Niveli:	Bachelor		
Statusi lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	IV		
Numri i orëve në javë:	2		
Vlera në kredi – ECTS:	6		
Koha / lokacioni:	Prishtinë, e hëne, prej 09:00 – 11:00		
Mësimdhënësi i lëndës:	Osman Ismaili		
Detajet kontaktuese:	Email: osmani1949@gmail.com		
Përshkrimi i lëndës			
	Lënda Metodologjia e shkrimit ligjor ka për objekt njohjen e teknikës juridike për të krijuar norma juridike si edhe aktet juridike. Lënda është e zbatueshme në drejtim të krijimit të normave juridike si edhe të akteve juridike pavarësisht llojeve të tyre. Rëndësia e kësaj lënde është e madhe dhe e pa imagjinueshme, sepse, studentët e gjeneratave të shkuara nuk kanë marrë njohuri lidhur me shkrimin e normave dhe akteve juridike, andaj, edhe kanë pas vështirësi në këtë drejtim. Kjo lëndë sa është teorike aq më tepër është praktike, sepse, njohuritë teorike vijnë në shprehje në fazën e krijimit të normave dhe akteve juridike.		
Qëllimet e lëndës:			
	<i>Qëllimi kryesor i lëndës është të paisë studentët me njohuritë bazike për metodat e draftimit të akteve juridike të përgjithshme dhe të veçanta duke studiuar dhe analizuar raste nga praktika.</i>		
Rezultatet e pritura të nxënies:			
	<i>Studentët do të demonstrojnë shkathtësitë e tyre praktike duke provuar draftimin e akteve juridike të përgjithshme dhe të veçanta duke aplikuar teknikat të cilat i kanë përvetësuar për gjatë të semestrit.</i>		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	4	15	60
Ushtrime teorike/laboratorike	1	4	16
Punë praktike			
Kontaktet me	2	15	30

mësimdhënës/konsultimet			
Ushtrime në teren			
Kollokfiime,seminare			
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgaditja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			
Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			
Metodologjia e mësimdhënies:			
	Interaktive, përmes pyetjeve dhe përgjigjjeve, ndarja në grupe të vogla diskutuese, përmes prezantimeve, punimeve seminarike, testeve provuese.		
Metodat e vlerësimit:			
	Pjesamrrja aktive në ligjërata dhe ushtrime, prezantimet, prezenca në ligjërata dhe ushtrime, kalueshmëria me sukses e testeve provuese. Kalueshmëria do të jetë e bazuar në kriterin e vlerësimit të testit final të provimit që do të kërkohet 50 % e pyetjeve të sakta. Përfshirja dhe llogaritjen e kontributit tjetër përgjatë ligjëratave të mbajtura për semester do të shërbejnë për sukses më të lartë.		
Literatura			
Literatura bazë:	<i>Constantin Stefanou, Helen Xanthaki, Drafting Legislation - A Modern Approach, Ratomir R. Lukiq, Metodologjia e së drejtës, përkthyer nga Prof. Dr.Osman Ismaili, Prishtinë, 2014</i>		
Literatura shtesë:	Dr. Mit'hat Shamiq: Si shkruhet vepra shkencore (përkthim në gjuhën shqipe) Shkup, 2008 <i>Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008</i> <i>Rregullorja e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës</i> <i>Rregullorhja e punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës</i> <i>Doracakë mbi drafitimin e akteve ligjore</i>		
Plani i dizajnuar i mësimi:			
Java	Ligjerata që do të zhvillohet		
Java e parë:	Njoftimi I studentëve me plan programin e lëndës		
Java e dytë:	Njohuri të përgjithshme për procesin ligjvënës		
Java e tretë:	Teknikat e hartimit të legjislacionit		

Java e katërt:	Interpretim i dispozitave kushtetuese dhe ligjore, diskutim me studentë
Java e pestë:	Draftimi i normave juridike – detyra në klasë
Java e gjashtë:	Draftimi i ftesës
Java e shtatë:	Draftimi i kërkesës
Java e tetë:	Draftimi i procesverbalit
Java e nëntë:	Draftimi i kontratës
Java e dhjetë:	Draftimi i vendimit
Java e njëmbëdhjetë:	Draftimi i aktakuzës
Java e dymbëdhjetë:	Draftimi i aktgjykimit
Java e trembëdhjetë:	Draftimi i ankesës
Java e katërbëdhjetë:	Draftimi i projektligjit
Java e pesëmbëdhjetë:	Përgatitje për provim dhe mbyllja e ciklit të ligjëratave duke përsëritur komplet matejalin

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<p>Vijueshmëria në ligjerata dhe ushtrime është obligative për të gjithë studentët e rregullt, përveq rasteve të arsyeshme të mungesës së raste të caktuara.</p> <p>Qetësia gjatë orës së ligjeratës apo ushtrimeve është esenciale në suksesin e lëndës andaj studentët duhet të mbajnë qetësinë në nivelin e duhur.</p> <p>Interaktiviteti gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është pjesë e rëndësishme e mësimdhënies dhe të gjithë studentët janë të inkurajuar që të marrin pjesë në mënyrë aktive. andaj studentët të cilët kërkojnë që të inkuadrohen dhe të japin mendimin e tyre në lidhje me temat e caktuara në kuadër të syllabusit të kësaj lënde mund të ngrisin dorën për të marrë fjalën.</p> <p>Kontakti me profesorin apo asistentin e lëndës mund të zhvillohet gjatë orëve të konsultimeve ose përmes emailit zyrtar.</p>